



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr.1036/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “REFORMA” SH.P.K., me NRB:..., me seli në Shkabaj, Obiliq, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Zyra Ligjore PRO JURIS, me seli në Prishtinë Rr.”...” C-2, H-1, Kati I, kundër debitorit Telekom i Kosovës Sh.A., me NUI:..., me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.38/21 të datës 11.01.2021, të Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 10.11.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Telekom i Kosovës Sh.A., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.38/21 të datës 11.01.2021 i Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj.
- II. MBETET në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.38/21 të datës 11.01.2021 i Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “REFORMA” SH.P.K., ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.38/21 të datës 11.01.2021, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës me nr. 232372 e datës 01.12.2020 dhe Faturës me nr.230387 e datës 02.11.2020, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që t’ia paguaj kreditorit shumën prej 19,517.20 €, me kamatë ligjore prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore në pajtim me UA-MD-së nr.06/2014 dhe të gjitha shpenzimet që do dalin gjatë procesit, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë, nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogaritë e tij bankare,

përmbaruesi privat zbaton përmbarimin përmes sekuestrimit të sendeve të luajshme dhe të paluajshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, duke theksuar se urdhëri si i tillë nuk mund të ekzekutohet dhe nuk është i përmbarueshëm, përkatësisht dokumentet e bashkangjitura propozimit për përmbarim nuk e kanë cilësinë e dokumentit të besueshëm sikurse është paraparë në nenin 29 të LPP-së. Ka shtuar se propozimi për përmbarim i kreditorit në bazë të kopjeve të faturave kontestuese është i pa bazuar sepse faturat nuk janë pranuar dhe nënshkruar nga debitori me qëllim që debitori të jetë në dijeni për borxhin e pretenduar, bazuar në këtë gjendje faktike rezulton shumë kjo se urdhëri përmbarimor është në tërësi i pa bazuar, sepse dokumenti ekzekutiv në bazë të cilit është marr vendim përmbarues ose urdhri përmbarimor, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarueshmërisë. Andaj i ka propozuar gjykatës ta provoj prapësimin si të bazuar, të abrogohet urdhri përmbarimor si dhe të obligohet kreditori që t'i paguaj shpenzimet e procedurës përmbarimor.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit, ndër të tjerash ka theksuar se nga prapësimi i debitorit vërehet qartazi se qëllimi i tij është vetëm shtyrja dhe prolongimi i pagesës së borxhit që ka ndaj kreditorit. I ka kundërshtuar pretendimet e debitorit me arsyetimin se urdhri përmbarimor është i bazuar, i ligjshëm dhe në përputhje me dispozitat ligjore përkatësisht me nenin 21, 22 par.1 nën par 1.1 dhe nenin 38 të LPP-së. Ka shtuar se debitori nuk ka parashtruar asnjë dëshmi me të cilën dëshmon se nuk e ka borxhin ndaj kreditorit, andaj prapësimi i debitorit nuk bazohet në asnjërin nga shkaqet e prapësimin të parapara në nenin 71 të LPP-së dhe si i tillë ky prapësim është i pa bazuar dhe thekson se faturat e lëshuara nga kreditori janë në origjinal të pranuar dhe të protokolluara nga debitori. Duke u bazuar në të lartcekurat i ka propozuar gjykatës ta refuzoj në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit, urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi si dhe të detyrohet debitori që t'i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore përfshirë edhe shpenzimet lidhur me ushtrimin e përgjigjes në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, shqyrtimit të përgjigjes në prapësim si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e

lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të cilave është lejuar urdhri për përmbartim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbartim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumentit i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*. Me neni 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm – Faturës me nr. 232372 e datës 01.12.2020 dhe Faturës me nr.230387 e datës 02.11.2020, të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Në rastin konkret rezulton se faturat janë dorëzuar në origjinal nga ana e kreditorit dhe janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, të njëjtat janë protokolluar në zyrën e pranimit të debitorit dhe përmbajnë vulën e pranimit si dhe nga fakti që faturat nuk janë kontestuar asnjëherë nga ana e debitorit.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit të paraqitur në prapësim, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për këtë çështje përmbartimore.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbare, vlerëson se urdhri për përmbare i lejuar mbi bazën e dokumentit të besueshëm nuk është në kundërshtim me dispozitën e nenit 29 të LPP-së, ngase nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbaremit siç përcaktohet në nenin 71 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

### GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1036/22, datë 10.11.2023

Gjyqtari  
Gent Bekeri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.